



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 3874 Prot

Lezhë, më 30 /03 /2026

VENDIM

Nr. 29, Datë 26. 03. 2026

**PËR DHËNIEN E DAKORDËSISË PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE PËR HEQJEN  
NGA FONDI PYJOR KOMBËTAR TË SIPËRFAQES PYJORE NË PRONËSI  
PRIVATE, PËR NDËRTIM OBJEKTI ME FUNKSION BANIMI DHE SHËRBIME ME  
1-6 KATE MBI TOKË DHE 1-3 KATE NËN TOKË NGA SHOQËRIA “DUKAGJINI  
GROUP” SHPK**

Bazuar në Ligjin nr. 139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Ligjin nr. 107/2014 datë 31.7.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", në Ligjin nr. 57/2020, datë 30.4.2020 "Për Pyjet", në VKM-në nr.888, datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", VKM-në nr. 267, datë 27.04.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", VKM-në nr. 537, datë 22.09.2021 "Për përcaktimin e kostove të përlllogaritura për pyllëzim kompensues, në rastet e ndryshimit të destinacionit të fondit pyjor", udhëzimin Nr. 1, datë 26.01.2017 të Ministrit Mjedisit "Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullësor kombëtar" pas shqyrtimit të dokumentacionit, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

Vendosi:

1. Të shprehë dakortësinë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor kombëtar sipërfaqen prej **0,2633 ha** pyll në pronësi private, sipas raportit tekniko ekonomik bashkëngjitur. Sipërfaqja që do të hiqet nga fondi pyjor privat detajohet si më poshtë:
  - **0.2633 ha** pyll në pasurinë 1000/85 zona kadastrale 2568, ngastra pyjore 62a, ekonomia pyjore "Mali i Rrencit".

2. Kostoja e rehabilitimit të sipërfaqes pyjore të dëmtuar, jashtë pjesës ku do të ndërtohet objekti, paguhet nga shoqëria “**DUKAGJINI GROUP**” sh.p.k përpara zbardhjes së lejes së ndërtimit, sipas marrëveshjes me Bashkinë Lezhë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar.

**SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI  
NDUE LULI**



kib

Nr. 3974/1 prot

Jt: 02.04.26



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 314/3 Prot.

Lezhë, më 01.04.2026

**Lënda:** Kthim përgjigje në lidhje me vendimin nr.29, datë 26.03.2026 të Këshillit të Bashkisë Lezhë

### KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

### KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Në përgjigje të shkresës suaj me nr.3979 prot, datë 30.03.2026 “Dërgim vendimesh të Këshillit të Bashkisë Lezhë“, protokolluar në institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë me nr.314 prot, datë 30.03.2026, bazuar në nenet 8 dhe 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut“ të ndryshuar, pasi shqyrtuam vendimin nr.29, datë 26.03.2026 të Këshillit të Bashkisë Lezhë “Për dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor kombëtar të sipërfaqës pyjore në pronësi privatë, për ndërtim objekti me funksion banimi dhe shërbime me 1- 6 kate mbi tokë dhe 1-3 kate nën tokë nga shoqëria “Dukagjini Group shpk si dhe dokumentacionin bashkëngjitur këtij vendimi konstatojmë si më poshtë:

Ky vendim në bazë të nenit 3, pika 2 të ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë“ nuk është akt me karakter normativ por është akt me karakter individual, konkretisht:

Vendimi nr.29, datë 26.03.2026 i Këshillit të Bashkisë Lezhë është akt administrativ individual pasi i drejtohet një subjekti të përcaktuar individualisht (Shoqëria “Dukagjini shpk“), krijon një marrëdhënie juridike konkrete dhe ka një pasojë konkrete (heqje nga fondi pyjor privat dhe ndërtimi objekte banimi dhe shërbimi), si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të nenit 8 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut“ të ndryshuar në ushtrim të funksionit të tij, përgjegjësi kryesore e prefektit të qarkut është verifikimin i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore.

Sa më sipër vendimi nr.29, datë 26.03.2026 i Këshillit të Bashkisë Lezhë është akt administrativ individual dhe nuk i nënshtrohet verifikimit ligjor nga ana e prefektit por hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore“. Por duke qene ky vendim i nënshtrohet procedurës së parashikuar në kreun II dhe III-të të VKM-së nr. 888, datë 27.12.2022“Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin

në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”, Prefekti i Qarkut pavarësisht së është vendim me karakter individual, bazuar në pikën 2 germa “d” të kreun III-të të VKM-së nr. 888, datë 27.12.2022, konfirmon ligjshmërinë e procedurës se ndjekur për marrjen e këtij vendimi .

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**PREFEKTI**

**Taulant MALSHI**

